



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Nr. 1 Datë 19.03.2018

Drejton mbledhjen gjyqtari i Gjykatës së Lartë si dhe kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, z. Artan Broci.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 12:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|-------------------------------|
| 1. Artan Broci | (kryetar) |
| 2. Altina Xhoxhaj | (anëtare) |
| 3. Rovena Gashi | (anëtare) |
| 4. Gentjan Trenova | (anëtar) |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 6. Enton Dhimitri | (anëtar) |
| 7. Fatos Qato | (anëtar) |
| 8. Ahmet Jangulli | (anëtar) |
| 9. Vitore Tusha | (anëtare zëvendësuese) |
| 10. Shkëlzen Selimi | (anëtar zëvendësues) |
| 11. Sotiraq Lubonja | (anëtar zëvendësues) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.**
- 2. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.**
- 3. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.**
- 4. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.**
- 5. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.**

Artan Broci: Kam thirrur mbledhjen e anëtarëve të KED. Kam ardhur në dijeni më datë 01.03.2018 nga kryetari i Gjykatës së Lartë për listën e kandidatëve që aplikojnë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Kam përcaktuar si rend dite:

1. Konstituimin e KED;
2. Dy shkresa të dërguara nga Presidenti i Republikës për dy vakanca të shpallura nga Presidenti;
3. Kam përcaktuar krijimin e një grupi për hartimin dhe shqyrtimin e rregullores që përcakton ligji;
4. Të tjera.

Kam marrë dijeni nëpërmjet fletores zyrtare nr. 14 të muajit shkurt 2018 se një nga anëtarët e zgjedhur z. Besnik Imeraj ka përfunduar mandatin e tij dhe kam një pyetje për ju mbi përfshirjen si anëtare zëvendësuese të znj. Tusha, e cila është anëtare e Gjykatës Kushtetuese, pra a duhet të mbajmë znj. Vitore Tusha si anëtare zëvendësuese apo duhet të veprojmë duke i kërkuar organit që e ka zgjedhur Presidentit të Republikës së pari dhe pastaj Kuvendit të Shqipërisë për zgjedhjen e një anëtari tjetër nga Gjykata Kushtetuese? ... Pra si Kushtetuta si ligji në asnjë dispozitë të tij nuk ndalon veprimtarinë e KED nga vetingu. KED nuk mund të pengohet. Kjo është një vendimmarrje që i takon Këshillit. Duhet të ndajmë ligjin nga morali.

Në mbledhje marrin pjesë: Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës z. Bledar Dervishaj, i cili me shkresën e datës 15.03.2018 ka njoftuar që do të jetë i pranishëm në mbledhje, me pjesëmarrjen e z. Genci Gjonçaj si përfaqësues i kryetarit të Kuvendit me shkresën e datës 19.03.2018, dy përfaqësues nga Komisioni i Çështjeve

Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, të pranishëm janë z. Ulsi Manja dhe z. Enkelejd Alibeaj, meqë ligji ka parashikuar se një nga anëtarët duhet të jetë nga opozita.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e zgjedhur të KED: znj. Xhoxhaj, znj. Gashi, z. Jangulli, z. Qato, z. Dhimitri, znj. Memçaj, z. Trenova po ashtu edhe anëtarët zëvendësues.

Mbledhjen e deklaroj të hapur. Jeni njoftuar për përmbajtjen e rendit të ditës. Pjesëmarrja dhe diskutimet janë të detyrueshme sipas ligjit.

Pra besoj se jeni njoftuar të gjithë me përmbajtjen e rendit të ditës, po kështu edhe me shkresën. ... dy shkresat e Presidentit të Republikës, të hartuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidentit më datë 28.02.2018 dhe 01.03.2018 më drejtohet mua në cilësinë e kryetarit të KED duke bërë njoftimin mbi vendimin për përzgjedhjen time si anëtar i KED.

Menjëherë kam komunikuar me kryetarin e Gjykatës së Lartë. Sigurisht në parimin e shtetit të së drejtës organet kushtetuese në pikëpamjen time anëtarët apo organet që zgjedhin këto organe duhet të njoftohen nga organi i emërtesës. Kam konstatuar se edhe kryetari i Gjykatës së Lartë nuk kishte dijeni zyrtare, por më ka vënë në dijeni më datë 02.03.2018 nëpërmjet shkresës së drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidentit më datë 01.03.2018 ... se jam zgjedhur si anëtar i KED ... Për mua duhet që njoftimi për zgjedhjen e anëtarëve të KED të jetë individual.

Meqë ligji na ngarkon me disa detyra, i jam drejtuar me shkresë meqenëse Gjykata e Lartë është personi juridik i cili lehtëson veprimtarinë e KED, që është organ kushtetues, e ka veprimtarinë e tij të pavarur, i kam kërkuar që sipas ligjit për arkivat, së pari regjistrin e KED, të krijohet personeli administrativ, ... i kam kërkuar kancelarit që në përputhje me ligjin për arkivat të prodhohet vula e KED, për një veprimtari të pavarur të KED.

I kam kërkuar kryetarin të Gjykatës së Lartë një numër të caktuar personeli administrativ dhe kryetari i Gjykatës ka caktuar: një sekretare dhe protokoll-arkivë, një specialist IT, zëdhënësen e shtypit dhe një këshilltar ligjor për të hartuar rregulloren dhe dokumentet ligjore.

Sigurisht që mbledhjet e Këshillit do të jenë në sistemin audio, mbledhja e parë që do të regjistrohet do të jetë audio. Procesverbali do e ketë të gjithë veprimtarinë e Këshillit dhe duhet pasqyruar në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Procesverbali sipas ligjit para se të firmoset do shikohet nga çdo anëtar për të parë përmbajtjen e tij dhe do të ballafaqohet me sistemin audio dhe e gjithë veprimtaria do të pasqyrohet dhe publikohet në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, siç e parashikon ligji 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës. Besoj se jeni njohur me fletoren zyrtare nr. 14 të shkurtit 2018, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, me mbarimin e mandatit të z. Besnik Imeraj, i cili është i zgjedhur në KED. Veprimtaria e KED, siç e dini organizohet dhe parashikohet nga dispozitat kushtetuese, por edhe nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, konkretisht nga pjesa V e këtij ligji, kreu I-rë. Në qoftë se ne i referohemi kreut të II-të, përbërja e Keshillit sipas nenit 220 të këtij ligji, ne kemi një mandat njëvjeçar me një përbërje prej 9 anëtarësh. Në pikën 3 të nenit 220 në rast pamundësie ose të konfliktit të interesit, anëtarët zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues. Pra meqë një nga anëtarët e zgjedhur z. Besnik Imeraj nuk ushtron më këtë detyrë për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 2 datë 31.01.2018 të Gjykatës Kushtetuese, sipas fletores zyrtare nr. 14, duke qenë se sipas shortit të organizuar nga Kuvendi anëtare zëvendësuese është përzgjedhur znj. Vitore Tusha, anëtare e Gjykatës Kushtetuese. ... A mund të sqarohet mbarimi i mandatit si pamundësi për të ushtruar detyrën e anëtarit të KED apo do të duhet që ne t’i drejtohem zyrtarisht me shkresë ... Do të doja opinionin tuaj.

Altina Xhoxhaj: Faleminderit zoti kryetar. Nuk e ndjej veten të detyruar të jap një mendim ... Megjithëse unë do sugjeroja ... Faleminderit.

Artan Broci: Atëherë sa për t’a sqaruar, ... neni 242 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” po t’a lexojmë ligjin anëtarët e KED mbajnë edhe përgjegjësi disiplinore ... Konsiderohet si shkelje disiplinore mosmarrja pjesë në diskutime ...

Rovena Gashi: S’jam dakort me znj. Altina Xhoxhaj ... Sipas nenit 223 në rastet e konfliktit të interesit ju jeni njohur me kandidaturat për Gjykatë Kushtetuese dhe një nga ato kërkesa është kërkesa ime për anëtare të Gjykatës Kushtetuese. Kështu që mendoj që personalisht jam në konflikt interesi për të marrë pjesë në të paktën në pjesën e renditjes dhe vlerësimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, por duke qenë që nga gjithë Prokuroria e Përgjithshme unë jam vetëm përfaqësuese, nuk ka anëtarë zëvendësues pasi ne jemi, përfaqësuesit e Prokurorisë janë, të vetmit persona me magjistraturë nga të cilët jemi dy apo tre ... Kështu që mendoj që çështja që duhet të shtrojmë për diskutim, për shkakun e paraqitjes së konfliktit të interesit është zgjedhja e anëtarit zëvendësues nga Prokuroria. Do zgjidhen nga Presidenti personat që nuk kanë Shkollën e Magjistraturës? Faleminderit.

Artan Broci: Z. Qato.

Fatos Qato: Unë jam i mendimit që neve duhet t'i drejtohem Kuvendit me shkresë, për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese që të hidhet shorti.

Artan Broci: Z. Dhimitri.

Enton Dhimitri: Faleminderit kryetar. Në lidhje me anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, ndaj të njëjtin mendim me z. Qato ... Në rastin e pamundësisë ose të konfliktit të interesit, në rastin konkret nuk ndodhemi para konfliktit të interesit. T'i drejtohem Kuvendit për fillimin e procedurave nga e para, caktimin e një anëtari të ri nga Gjykata Kushtetuese.

Artan Broci: Znj. Memçaj.

Fatjona Memçaj: Faleminderit z. kryetar ... Gjykoj që anëtari zëvendësues ka të bëjë me raste përjashtimore ...

Artan Broci: Faleminderit znj. Memçaj. Z. Trenova.

Gentjan Trenova: ... Jam i mendimit që të hidhet short. Nëqoftëse Presidenti se ushtron këtë të drejtë i kalon Kuvendit ...

Artan Broci: Z. Jangulli.

Ahmet Jangulli: (Nuk dëgjohet).

Artan Broci: Duke qenë se kemi thirrur mbledhje të zgjeruar me anëtarët zëvendësues dua opinionin e anëtarëve zëvendësues duke filluar nga znj. Tusha, z. Selimi, z. Lubonja, dhe opinionin e Avokatit të Popullit meqë asiston në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit 115/2016.

Vitore Tusha: ... Mendoj që zëvendësuesi është për një pamundësi të përkohshme ...

Artan Broci: Po z. Selimi.

Shkëlzen Selimi: Përshëndetje. Mirë se keni ardhur në Gjykatën e Lartë. Unë nuk e shoh aq ngushtë termin pamundësi. Nuk ndaj të njëjtin opinion me kolegët, se ne jemi anëtar të KED dhe kjo nënkupton që ne pra jemi gjyqtar në të gjitha nivelet si në Gjykatë Kushtetuese, në Gjykatë të Lartë, apel apo shkallë të parë. Pra për mua kjo pamundësi lidhet edhe me një pengesë qoftë të përkohshme por edhe të përhershme. Funkzioni primar është ai i gjyqtarit dhe më pas kryhet funksioni apo përgjegjësia e anëtarit të KED. Pra mbarimi i mandatit për mua është një nga rastet e pamundësisë. Në çdo rast duke iu referuar ligjit kemi funksionin normal por kemi edhe element zhbllokues. Pra do të thotë KED nuk mund të ngelet peng për një njeri, për një vakancë apo për një shkak tjetër. Prandaj opinionin im do të ishte që, bashkohem me pjesën tjetër për sa i përket që t'ju drejtohem instancave për zhbllokimin e kësaj vakance, por Komisioni duhet të vazhdojë

punën duke marrë një situatë ideale dhe në çdo rast duhet të zëvendësohet nga anëtari zëvendësues.

Artan Broci: Z. Lubonja.

Sotiraq Lubonja: Unë ndaj të njëjtin qëndrim me parafolësin ... Ligji ka parashikuar dhe shkaqet për zëvendësimin kur kemi pamundësi ose vakancë. Problemi që shtrohet në lidhje me, kur kemi mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, pra do zërë vendin e anëtarit të momentit apo në zgjedhjet që do të vijnë do vijë në funksion, pra shorti i ri që thoni ju ... do të jetë short që do të zëvendësojë atë që ka përfunduar mandatin, pra anëtarin apo zëvendësuesi do vazhdojë të zërë vendin e anëtarit që i ka mbaruar mandati? Faleminderit.

Artan Broci: Po faleminderit z. Lubonja. Në fakt shtrova për diskutim çështjen që folëm me kolegët sepse ligji e ngarkon zëvendëskryetarin e KED, i cili është një nga anëtarët e zgjedhur. Ne jemi me një mandat njëvjeçar, ligji parashikon një kryetar dhe një zëvendëskryetar, për zëvendëskryetar ligji parashikon një anëtar të zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese dhe meqenëse ne nga Gjykata Kushtetuese kemi efektiv një anëtar dhe një anëtar zëvendësues duhet të sqarohet roli i zëvendëskryetarit të KED sepse zëvendëskryetari ka disa detyra të përcaktuara me ligj: një prej tyre është në zgjidhjen e vendimmarrjes në papajtueshmërinë e kryetarit të KED në shqyrtimin e kandidaturave dhe për dorëheqjen e kryetarit vendos zëvendëskryetar. Prandaj e shtrova për diskutim zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KED. Faleminderit. Fjalën e ka Avokati i Shtetit.

Erinda Ballanca: e Popullit

Artan Broci: Avokate e Popullit. Më falni.

Erinda Ballanca: S'ka gjë. Atëherë unë jam më tepër për të bërë një rezymë deri tani sepse me të vërtetë ... Ka një historik deri më tash, një historik të cilin eventualisht, pikërisht për shkaqe të natyrave procedurale ju si anëtarë të KED ... të disa qëndrimeve të cilat janë mbajtur më parë ... në momentin në të cilin është zgjedhur KED-ja e parë anëtari i parë nga Gjykata e Lartë ka qenë znj. Mirela Fana dhe anëtari zëvendësues i saj ishte z. Artan Zeneli, gjyqtar. Duke qenë se znj. Fana dha dorëheqjen nga ajo punë, ajo nuk mundi të konstitujë asnjëherë Këshillin dhe nuk mundi të, nuk e kreu asnjëherë veprimin e saj edhe për shkak se kishte përfunduar mandati i saj dhe se anëtari i KED është për shkak të funksionit të tij gjyqtar ... Më tej është, duke qenë se anëtari zëvendësues ... ishte z. Zenelaj ai i ka bërë një qëndrim të caktuar në atë kohë Kuvendit dhe Presidentit të Republikës që të hidhej shorti. Pra ky veprim bëhej në një fare mënyre për të

konsideruar se ai nuk e konsideronte veten si anëtar i kryetarit zëvendësues, pra të kishte rolin për të bërë çdo lloj veprimi dhe për të thirrur mbledhjen e Këshillit ... për sa kohë që në gjykimin e tij ... Në lidhje me faktin nëse arrinte apo a mund t'a konsideronte në kuptim të ligjit apo jo anëtari zëvendësues i anëtarit përfaqësues dhe kjo është një çështje e cila ... institucioni i Avokatit të Popullit në këtë pjesë dhe për faktin se kryetari i KED është një nga anëtarët e disa Komisioneve për zgjedhjen e personave që mund të jetë në organet drejtuese të Këshillit të Drejtësisë, pra KLGJ dhe KLP. Arsyeja pse unë i di këto është sepse institucioni i Avokatit të Popullit i ka kërkuar të marrë pjesë në mbledhje kryetarit të KED me kërkesë në procesin e përzgjedhjes të anëtarëve në rradhët e atyre që vijnë edhe nga Avokatia në këto organet e Këshillit të Lartë dhe për këtë kemi një korrespondencë të gjerë kemi marrë ... Është marrë nga Avokati i mëparshëm, këto janë veprime të kryera përpara se unë të merrja detyrën dhe në opinionin e dhënë në atë rast konsiderohej, kishte një qëndrim më duket, se shorti nuk mund të hidhej dy herë, pra shorti hidhej vetëm në dhjetor në gjykimin tim për këtë pjesë sigurisht që besoj se secili prej jush ... sesa ata që e kanë dhënë këtë opinion nuk ka lidhje, detyrimi për të bërë shortin nuk kanë lidhje me afatin ... të gjithë veprimet kanë ikur dhe shorti është mekanik ... në gjykimin tim dhe fakti se kryhet në dhjetor për zgjedhjet apo për mënyrën dhe ecurinë caktohet një afat për të siguruar garantimin dhe ecurinë e KED-ve të viteve të mëtejshme dhe që lidhet më tepër me mandatin njëvjeçar të secilit prej anëtarëve nuk do të thotë se do të bëhet kusht për mosrregullimin e një sistemi ndoshta nëse mund t'a konsiderojmë një anomalie ligjore për efekt të një mungese apo të vakancave në Këshill. Pavarësisht kësaj, pra unë mendoj që ne si organ në të gjitha rastet do duhet që t'i kemi parasysh edhe këto qëndrime dhe veprime të mbajtura më mërrapa ndoshta për të vlerësuar dhe interpretimet rast pas rasti në lidhje me këtë çështje, por fakt është që KED-ja e mëparshme nuk është konstituuar asnjëherë dhe nuk ka kryer ndonjë gjë në lidhje me këtë duke qenë një rast i ngjashëm të themi, pavarësisht se në atë rast kryetari ... funksioni për efekt të funksionit por këto janë çështje të cilat do të duhet ndoshta të kemi një qëndrim ndoshta pak më të, më analitik të çështjes ... në gjykimin tim kryerja e funksioneve apo vazhdimi i Këshillit është shumë i rëndësishëm pra mosushtimi i detyrave të tij është shumë i rëndësishëm, aq më tepër në një kohë që kërkohet është një kërkesë e domosdoshme e kohës që ky Këshill të vazhdojë secili të vazhdojë me punët që ka për të bërë sepse në momentin që ne flasim institucionet e drejtësisë janë pothuajse në kolaps, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë në vakancë, por ndërkohë edhe në Gjykatë të Lartë dhe duhet të

bëjmë një vlerësim të gjithë sensit të drejtë të kuadrit se çfarë realisht është thelbësore dhe e rëndësishme në kuadër të ... që ekziston nga vakancat kushtetuese në këto organe. Unë për momentin do t'jua sjell me email do t'jua sjelli sekretariati materialet, të cilat për historik ka pasur më parë për këtë çështje, por rezulton se ka pasur një vullnet të përgjithshëm të Presidentit në atë kohë dhe Komisionit të Ligjeve në atë kohë sot janë organe që përfaqësohen nga persona të ndryshëm që nuk do të kishte një short tjetër në lidhje me ... Megjithatë mundet ndoshta të kemi qëndrime të ndryshme si nga Presidenti i Republikës dhe nga Kryetari i Kuvendit apo nga Komisioni i Ligjeve ... Duke qenë se unë jam në dijeni të këtyre fakteve mendova t'jua paraqes edhe për njohuri dhe për transparencë, jo për shkak të marrjes pjesë në këtë forum siç e thashë sepse nuk është mbledhur asnjëherë KED-ja, por për shkak të faktit se ne kemi pasur një korrespondencë me z. Zenelaj për këto në të gjitha rastet për të marrë pjesë në Komision në zgjedhjen e anëtarëve nga Avokatia për Këshillin e Lartë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Faleminderit.

Artan Broci: Faleminderit znj. Ballanca për opinionin dhe transparencën në këtë Këshill. Besoj se duke qenë gjyqtar më mirë se ne kush do e bëjë detyrën ... Unë besoj se pavarësisht nga emri që ka Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ne thjesht bëjmë listimin dhe rankimin e kandidaturave dhe ja paraqesim më pas organeve përkatëse Kuvendit ... Zgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë këto janë dy objektet e veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Unë besoj se konstituimi i sotëm ka të bëjë me konstituimin normal, të cilin e parashikon ligji si mbledhje me të paktën 8 anëtarë pastaj ne çështjet që trajtojmë kanë të bëjnë me çështje të veprimtarisë së Këshillit. Unë do doja në fakt të kisha opinionin ligjor meqenëse ligji parashikon mbledhjen me dy përfaqësues të Komisionit të Çështjeve Ligjore ... Faleminderit.

Enkelejd Alibeaj: Z. kryetar, të nderuar anëtarë të KED-së, së pari faleminderit për ftesën dhe së dyti për faktin që morët pjesë ... për të zhvilluar veprimtarinë e organit tuaj i cili është shumë i rëndësishëm ... në sistemin e drejtësisë. Lidhur me pyetjet tuaja dhe me çështjet që juve i diskutuat opinionin im jo personal, por në bazë të titullit që ligji parashikonte si përfaqësues i Komisionit të Ligjeve është ky: konstatimet që ju bëtë në fillim të mbledhjes lidhur me mungesën e një anëtari të zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese dhe mundësinë për t'a zëvendësuar atë prej zëvendësuesit apo me një procedurë ex novo shorti ja vlen të diskutohet në mënyrë që ky problem të zgjidhet sot dhe të mos dali nesër për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Këshilli të

Emërimeve në Drejtësi. Së dyti, ligji thotë po atë çfarë një pjesë e kolegëve tuaj pretendon që zëvendësuesi i anëtarit që nuk është më pjesë e KED të futet në lojë në rastet episodike në rastet kur ka konflikt interesi apo kur mungon. Kjo është e vërtetë. Po kaq është e vërtetë edhe parashikimi tjetër: anëtarët e KED janë të detyruar të jenë prezent ... Kjo do të thotë hipotetakisht asnjë anëtar i KED nuk mund të mungojë. Janë dy parashikimet ligjore pozitive të shkruara në ligj ... dhe ligji është i qartë, por që ligji ka edhe probleme në këtë e di. Duke qenë se ka argumenta të njëjtë përgjithësisht dhe kjo ishte një rast dhe nga ana tjetër, besoj që në këto raste teknika e duhur është ajo e interpretimit ... dhe në funksion të qëllimit, pra që veprimtaria e KED e para të mos pengohet dhe e dyta që KED ka të drejtë ai vetë të marrë dhe të vendosë në diskutim prezencën ose jo të një anëtari apo zëvendësuesi eventual të tij. Kjo do të thotë që është çështje midis Gjykatës Kushtetuese, Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe jo e këtij Këshilli. Së dyti siç edhe Avokatja e Popullit e tha për shkak të bindjeve si përfaqësues i Komisionit të Ligjeve jo personalisht në atë kohë, por e kam ndjekur korrespondencën e dikurshme midis zëvendësuesit dhe kryetarit të KED në rastin e parë dhe Avokatit të Popullit, po dhe Kuvendit, pra Komisionit të Ligjeve. Qëndrimi i mbajtur nga Kuvendi nëpërmjet Komisionit të Ligjeve ka qenë ky: zëvendësuesi e zëvendëson atë që nuk është më anëtar i KED sa herë që ai mungon, konflikt interesi, mospasja dëshirë për të marrë pjesë apo dorëheqje ... Ky është qëndrimi i organit i cili ka bërë ligjin dhe në një farë mënyre mund t'a konsiderojmë si një lloj interpretimi autentik të organit që e ka lexuar ligjin. Kështu që për këto arsye, ky është qëndrimi i njërit prej përfaqësuesve të Komisionit të Ligjeve, pra siç e thashë, nëse një anëtar i Gjykatës Kushtetuese mungon zëvendësuesi merr pjesë me cilësi të plota. Ju falenderoj për mundësinë që më dhatë.

Artan Broci: Faleminderit juve z. Alibeaj.

Ulsi Manja: Faleminderit z. kryetar. Faleminderit të nderuar anëtarë. Unë do t'a nis dhe do të jap një mendim. Unë po shpreh qëndrimin zyrtar edhe si kryetar i Komisionit të Ligjeve, por edhe si përfaqësues shumicës parlamentare. Ka një vendim të Kuvendit që është i qartë se kush janë anëtarët e KED, kush janë zëvendësuesit. Znj. Tusha është anëtare e KED në rastet e pamundësisë së ushtrimit të funksionit ... Po në rast se një anëtar i KED mund të mos jetë fizikisht, jo prezent, por mund të mos jetë fizikisht, vdes, larg qoftë, këtu shqyr jemi shëndoshë si kokrra e mollës të gjithë, kështu që në këtë drejtim, në këtë kuptim z. Imeraj ishte anëtar i KED për shkak të funksionit gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nuk është më gjyqtar në Gjykatën

Kushtetuese, por kjo nuk e pengon aspak znj. Tusha si anëtare e KED të jetë prezente në mbledhje qoftë edhe rast pas rasti në çdo mbledhje që ju po thërrisni, sepse ti e the vetë që është një Këshill i përkohshëm në Drejtësi që ushtron një veprimtari në harkun kohor të një viti. Kështu tani çështja që han diskutime është çështja e konfliktit të interesit që paraqiti znj. Gashi sepse nga Prokuroria, sepse nga institucioni i Prokurorisë nuk kemi zëvendësues kështu që duhet ta diskutoni në herën tjetër. Pra unë e shoh të zgjidhur këtë çështje. E dyta që kam për të shtruar lidhur me ekskluzivitetin e KED ndryshe nga sa parashtroi Avokatja e Popullit ky është momenti zyrtar i konstituimit për herë të parë të KED. Ky Këshill është ngritur konform Kushtetutës, me ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ka pasur si normë juridike të ngritjes nenin 179 pika 1e Kushtetutës, nenin 149/d pika 3 e Kushtetutës dhe nenin 284 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Desha të sillja në vëmendje të këtij Këshilli dy aspekte, aspekti i parë ka të bëjë me veprimtarinë administrative të vetë Këshillit që garanton mbarëvajtjen dhe transparencën e punës së vetë Këshillit dhe që ... Aspekti i dytë lidhet me veprimtarinë kushtetuese dhe ligjore të Këshillit në raport me ndikimin e kushteve ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve dhe renditjen e kandidatëve dhe në këtë pikë do të dua të sjell në vëmendje të Këshillit as më shumë dhe as më pak parashikimin që ka bërë Kushtetuta, neni 179 pika 11 e Kushtetutës, e cila për hir të vërtetës ndryshe nga të gjitha institucionet e drejtësisë që krijohen për shkak të reformës në drejtësi në të cilat vetë ligji shprehet që i nënshtrohen me përparësi procesit të vetingut, le të themi për anëtarët e Këshillit Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në rastin konkret për anëtarët e KED thotë neni konkret i Kushtetutës i nënshtrohen menjëherë procesit të rivlerësimit kalimtar për gjyqtarë dhe prokurorë, që do të thotë kur të vihet në këtë aspekt të veprimtarisë së Këshillit, natyrisht do të duhet të ketë një rezultat konkret të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Por gjithsesi kjo nuk e pengon punën e këtij Këshilli sepse puna e Këshillit ka dy aspekte, aspektin gjyqësor që e përmenda dhe aspektin e dytë, përpos që dhe ligji për organet e sistemit të drejtësisë ka parashikuar dhe afate konkrete për verifikimin e kushteve ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve, pra nga Presidenti i Republikës apo që do të vijne nesër nga Kuvendi, për Gjykatën Kushtetuese si dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë sepse në fund të fundit KED-së këto dy detyra i ka ngarkuar Kushtetuta, përzgjedhjen e kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Kështu që i uroj punë të mbarë.

Artan Broci: Jo përzgjedhjen por listimin e kandidatëve.

Ulsi Manja: Listimin, më falni, por KED në rast se nuk funksionon mekanizmi i parë, KED dhe renditja që ju bëni është mekanizëm ligjberës, kështu që gjithsesi në rast se Presidenti nuk do të arrijë që brenda 30 ditëve të emërojë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që i takojnë Presidentit vendimi juaj është nul.

Enkelejd Alibeaj: Z. kryetar, ju kërkoj ndjesë, por jam në një angazhim tjetër pranë Kuvendit, ndaj duhet të largohem. Faleminderit për ftesën. Faleminderit të gjithëve.

Artan Broci: Z. Manja, nëse ka diçka tjetër për të shtuar.

Ulsi Manja: Jo, unë nuk kam asgjë për të shtuar. Kështu që juve ju uroj punë të mbarë në këtë mbledhje të parë që është konstituive. Natyrisht s'më mbetet gjë tjetër veçse për t'ju uruar punë të mbarë dhe do keni natyrisht edhe mbështetjen dhe përkrahjen tonë për atë që na takon.

Artan Broci: Faleminderit z. Manja. Në fakt Kushtetuta ... Kushtetuta është e vërtetë që ka parashikuar konstituimin e KED, por si do të veprojë KED, më lejoni që në emër të këtij Këshilli t'i bëj thirrje Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të kryejë punën e tij ... Unë besoj se secili prej nesh ka shprehur vullnetin për të bashkëpunuar me Këshillin e Emërimeve ... Kështu që i jap fjalën përfaqësuesit të kryetarit të Kuvendit.

Genci Gjonçaj: Faleminderit z. kryetar ... E para, kryetari i Kuvendit është njohur me mosushtrimin e funksionit të KED, që nuk është konstituuar me një short të parë të KED. Për shumë arsye juve jeni në dijeni që KLGJ dhe KLP s'kanë funksionuar asnjëherë ... pavarësisht faktit që Kuvendi ... dhe në këtë rast ne jemi para KED-së së re e kompozuar në bazë të thirrjes që bëtë ju, përfitojmë t'ju themi z. kryetar, se në bazë të njoftimit tuaj mbledhja ka qenë e hapur, publike, në mbledhje kanë ardhur përfaqësues të institucioneve të përfaqësuar, ka qenë media dhe shorti ka qenë sipas ... Kjo ishte për çështjen e parë. Për çështjen e dytë lidhur me zëvendësimin e anëtarit të dorëhequr të Gjykatës Kushtetuese, edhe ne mbetemi të mendimit që ligji dhe Kushtetuta ka parashikuar zëvendësimin ... qoftë në rastin e përkohshmërisë kur bëhet i pamundur ushtrimi i funksionit ashtu edhe në rastin kur një anëtar ... bëhet i pamundur për ... mënyra si është zgjidhur është parashikuar në short me zgjedhjen e një anëtarit zëvendësues ... në të kundërt ... me kërkesë të organit ... drejtuar Presidentit apo Kuvendit në rastet kur nuk zgjidhet ... dhe për tu kthyer te çështja e fundit është shumë korrekte që leximi i Kushtetutës duhet të jetë njësoj sepse është ajo që prevalon dhe është vendimtare përse i takon pjesës së KED ... Ky është një element substancial i ligjit qoftë nga ana ... qoftë në rastin e ... dhe për këtë gjë

unë besoj që secili nga anëtarët e grupit, të KED duhet të ... sepse Kushtetuta i imponon të shprehet menjëherë, ndryshe nga ç'përmend në strukturat apo organet e tjera të krijuara ... KED-së këtë ia imponon drejtpërdrejt që të mblidhet në mënyrë të menjëhershme ... por besoj që një vendimmarrje e rëndësishme duhet padyshim të bëhet pasi të kryhet ky proces ... Fjala vjen nga Presidenti i Republikës kanë ardhur kandidaturat për në Gjykatën Kushtetuese, të cilat duhet të fillohen të administrohen nëpërmjet një sërë rregullash ... Këto ishin komentet që kisha unë. Faleminderit për ftesën.

Artan Broci: Faleminderit. I jap fjalën përfaqësuesit të Presidentit.

Bledar Dervishaj: Faleminderit të nderuar anëtarë. Faktikisht nuk do të doja të përsërisja asgjë nga ato që u tha por dy momente shkurt, pasi vërtet mori shumë kohë. Në dhjetor të vitit të kaluar ka pasur një korrespondencë, jo vetëm midis tyre Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, por edhe të misionit Euralius dhe të partnerëve të tjerë ku është konkluduar në lidhje me nevojat e hedhjes së shortit të ri për zgjedhjen e anëtarëve të KED dhe për aq kohë sa ... dispozitive tranzitore dhe ky lloj interpretimi i ri ose kjo situatë ekstraligjore na detyroi që të shprehim pamundësi për t'a hedhur shortin për t'a deleguar këtë të drejtë te Kuvendi si organ i vetëm ... të paktën në lidhje me situatën. Rezulton se shorti u hodh dhe ashtu siç ju e diskutuat u njoftuam edhe ne si President i Republikës në lidhje me rezultatin e këtij shorti. Por ndërkohë u njoftuam edhe nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me vakancën e parakohshme të krijuar, për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Për sa i takon zëvendësimit të anëtarit me anëtarin zëvendësues pamundësia dhe zëvendësimi nëpërmjet anëtarit zëvendësues gjyqtar dhe anëtar i këtij Këshilli mund ta gjejmë zgjidhjen edhe te vetë vendimi i Gjykatës Kushtetuese kur thotë që ka dhënë dorëheqjen për shkaqe personale dhe pamundësie dhe kjo tregon që është i zbatueshëm neni 220 pika 3 mbi vazhdimësinë funksionale të këtij Këshilli. Pastaj nëse KED-ja vendos t'i drejtohet Presidentit dhe Kuvendit mbi atë që ju diskutuat është në të drejtën tuaj, por që organizimi dhe funksioni i drejtësisë i këtij Këshilli duhet të vazhdojnë. Si institucioni i Presidentit të Republikës meqenëse ne jemi organi kompetent për dy vakanca të krijuara i kërkojmë këtij Këshilli vijimin e punës me qëllim formalizimin edhe të atyre akteve nënligjore, pranimin më pas të dosjeve që janë ende në institucionin tonë e më pas vijimin e procedurës që do diktojnë edhe vendimmarrja juaj. Kaq kisha.

Gentjan Trenova: ... kështu që në lidhje me këtë ka diskutime në qoftë se zëvendësuesi do të futet dhe do të zërë vendin bosh edhe sikur t'a marrim këtë si ide përsëri mbetet vendi i

zëvendësuesit bosh dhe gjithashtu ... dhe Presidentit dhe Kuvendit t'i drejtohem, t'a caktojë vetë Presidenti apo Kuvendi rolin e zëvendësimit nëse do jetë i përhershëm apo ...

Artan Broci: Bëjmë një ndërprerje për një pushim të shkurtër. Mbledhja pritet të fillojë në orën 11:20. Faleminderit. Mirupafshim.

(Ndërpritet mbledhja për shkak të një pushimi të shkurtër)

Artan Broci: Mirë atëherë. Rifillojmë mbledhjen e KED për të vazhduar me rendin e ditës. Unë besoj se duke marrë këshillimin dhe opinionin e anëtarëve të KED dhe të përfaqësuarve nuk ka pengesë për të vazhduar punën e KED ... Pika e dytë e rendit të ditës është ...

Enton Dhimitri: A është e nevojshme t'i bëjmë një shkresë institucioneve? Po anëtari zëvendësues? Mund të krijohet një moment bllokimi pasi nuk mund të jetë kryetari.

Artan Broci: Faleminderit z. Dhimitri. Pra unë shtova që KED ... për anëtarin e Këshillit i cili ka ushtruar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese ... për rihedhjen e shortit, por unë mendoj se nuk kemi pengesë me vazhdimin e funksionimit të Këshillit, ndërsa përsa i takon zëvendëskryetarit atë e përcakton neni 227 i ligjit nr. 115/2016, i cili thotë se anëtari më i vjetër në moshë nga Gjykata Kushtetuese është zëvendëskryetari i Këshillit. Atëherë pikërisht për vakancat e krijuara bëme interpretimin e ligjit ashtu sikurse na ka udhëzuar dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj ... Besoj se ... Këshilli mund të bëjë interpretimin e normës për të vazhduar funksionimin. Çështja pastaj e ditës, për diskutim dhe për interpretim në një fazë të dytë ... Për të vazhduar me rendin e ditës, pika e dytë e rendit të ditës është dy shkresat e ardhura nga Presidenti i Republikës në lidhje me dërgimin e listave. Mendoj se përpara se të diskutojmë mbi shkresat unë jam pak për të analizuar pikën e tretë të rendit të ditës, krijimin e një komisioni për hartimin e rregullores, pra veprimtaria e KED sipas ligjit ka dy funksione kryesore: rankimin dhe renditjen për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të bërë sipas një procedure të përcaktuar nga ligji dhe rregulloreve përkatëse. Unë besoj se përpara se të kalojmë në administrimin e akteve të sjella nga Presidenti apo nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili ka shpallur vakancën e dytë në listimin e tij publik besoj se do ishte mirë të rregullojmë veprimtarinë e Këshillit me rregullore. Do të doja miratimin e Këshillit në lidhje me mendimet që mund të ketë kryetari i Këshillit ... për vazhdimin e reformës në drejtësi, miratimin e rregullores, caktimin e një grupi anëtarësh për hartimin dhe përcaktimin e rregullores së veprimtarisë së Këshillit. (Audio ka zhurmë) ...

Altina Xhoxhaj: Ju faleminderit z. kryetar. Unë nuk kam asnjë mendim personal, do dëgjoj anëtarët e tjerë.

Rovena Gashi: Po faleminderit z. kryetar. Meqenëse, sipas mendimit tim duhet të ... të jemi profesional për të nxjerrë udhëzimet për funksionimin e këtij institucioni. Faleminderit.

Artan Broci: Z. Qato.

Fatos Qato: Mendimi im është që të bëjmë një projektregullore për këshillimin që të na vijë ... të përgatisim nuk do të thotë t'i japi zgjidhje të gjitha çështjeve, por po bëjmë një projekt të parë kjo nuk do të thotë që, por ndonjë opinion t'a marrin nga ... të paktën të jetë një rregullore e cila do këshillojë ... kështu që unë them të përgatitet një draft, të njihemi dhe pastaj të shfaqim mendim ...

Artan Broci: Faleminderit. Z. Dhimitri.

Enton Dhimitri: Unë do shprehja sepse ka një moment që duhet autorizimi për organet për të marrë pjesë në mbledhje apo duhet t'i konsiderojmë komponent teknik kur ... Sikurse u tha, sikurse është parashikuar në ligj, mbledhjet janë të mbyllura dhe parashikohen anëtarët të cilët duhet të marrin pjesë ... në kuptim të transparencës së procesit nuk besoj që ka diçka këtu për të diskutuar, do verifikojmë kandidaturat.

Artan Broci: Atëherë, siç u shtrua në diskutim, për sa i përket transparencës, pjesëmarrja dhe forumi janë përcaktuar në procedurat ligjore, sigurisht mbledhjet e Këshillit janë me dyer të mbyllura thotë ligji, neni 233 pika 1. Ka përcaktuar pjesëmarrësit kush janë, por miratimin e rregullores që na e kërkon ligji, se kërkojmë një mendim profesional nga misioni Euralius apo misione të tjera që asistojnë reformën në drejtësi, unë besoj se nuk ka ndonjë pengesë. Por në veprimtarinë e kryetarit të KED kërkohet një autorizim nga Këshilli, domethënë që vendimet janë kolegjiale, pra unë s'mund të dal jashtë autoritetit që më ka dhënë ligji për tu konsultuar dhe për asistim, pa marrë miratim nga Këshilli. Unë kam parashikuar në rendin e ditës krijimin e një grupi pune sigurisht për t'a ... Kam marrë parasysh se secili prej jush është njohur me ligjin. Ligji na ngarkon nga pikëpamja e tij me krijimin e disa rregulloreve për funksionimin e Këshillit, qoftë edhe për vazhdimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe për hartimin e këtyre rregulloreve, sigurisht unë mendoj që përveç grupit që do ngrëjmë të marrim edhe një opinion ligjor nga misionet e asistencës, për sa kohë që krijohet KED si organ kushtetues. Ky është mendimi im. Faleminderit. Znj Memçaj.

Fatjona Memçaj: Unë z. kryetar nuk e shoh ... përgatitjen e rregullores nuk e shoh gjë të keqe të kemi asistencë dhe të jemi të hapur. Edhe pjesëmarrjen në mbledhje nuk është shkelje apo vendime që do të marrë Këshilli. Do ju sugjeroj ... asistencën e Avokatit të Popullit ose edhe opinionin ...

Gentjan Trenova: Atëherë dakort me ato gjërat që u thanë. Unë besoj se ... paralelisht me këtë mund të bëjmë ... të bëjmë paralelisht një projektregullore dhe pastaj të vendosim.

Fatjona Memçaj: Unë mendoj që siç e diskutova edhe më parë punën do e bëjmë ne, por se marrim diçka nga ana teknike, diçka më shumë sesa mund të bëjmë ne një rregullore.

Artan Broci: Atëherë për sa u diskutua unë mendoj se duhet të krijojmë një grup pune, në rradhë të parë për hartimin e projektregullores, e cila sigurisht me autorizimin e Këshillit do kërkohet asistencë e misionit Euralius apo misioneve të tjera që asistojnë reformën në drejtësi dhe pasi të kemi marrë mendimin e tyre për projektet e tyre atëherë ne do t'jua shpërndajmë anëtarëve për tu njohur me projektet dhe bashkërisht t'i rregullojmë sipas rradhës përpara se të marrin miratimin nga ky Këshill. Faleminderit. Fjala është për znj. Tusha si anëtare e këtij Këshilli.

Vitore Tusha: ... ju keni tagra për të bashkëpunuar me organet e tjera ...

Ahmet Jangulli: ... të bëhet më e mira për rregulloren ... Faleminderit.

Artan Broci: Mirë atëherë unë propozoj një grup pune për hartimin e projektregullores të KED-së, për veprimtarinë e këtij Këshilli, në kushtet para miratimit të anëtarëve të saj. Si anëtarë propozoj dy anëtarët nga Gjykata Kushtetuese për hartimin e projektregullores e cila do hartohet nga ky grup pune, të cilët do hartojnë një mendim ligjor dhe relacion për të gjithë anëtarët e KED-së, në mbledhjen e këtij Këshilli. Kush është dakort?

Altina Xhoxhaj: Ju faleminderit z. kryetar. ... Në të vërtetë KED miraton një rregullore të brendshme. Në nenin 230 thuhet shprehimisht se kryetari i KED bashkëpunon me kryetarin e Gjykatës së Lartë, cakton nga rradhët e personelit administrativ të Gjykatës së Lartë, një numër të arsyeshëm punonjësish administrativë për të lehtësuar përmbushjen e detyrave të Këshillit. Mendoj që ju si kryetar mund të caktoni një grup pune nga Gjykata e Lartë që të paraqesin një projektregullore dhe pastaj të gjithë ne të votojmë për projektin sepse siç e dimë KED është me afat shumë të kufizuar njëvjeçar. ... Nuk mendoj që të jenë vetëm 3 anëtarë që të punojnë me projektregulloren pasi siç e thotë neni 230, KED mbështetet nga stafi administrativ i Gjykatës së Lartë ...

Artan Broci: Faleminderit znj. Xhoxhaj. Në fakt unë ju kujtoj se kryetari i Gjykatës së Lartë me shkresë i ka caktuar KED-së një këshilltar ligjor për hartimin e rregulloreve dhe si relator në lidhje me listimin apo rankimin, por sigurisht ai do përgatiti dhe materialet, draftet ku një konsulencë do jetë e një grupi pune për të mos angazhuar të gjithë Këshillin, do jetë një grup minimalist, pra për tu marrë një mendim shkencor të draftit të përgatitur nga administrata, për t'ja përcjellur pastaj më pas me shkresë përcjellëse institucioneve dhe ... për miratimin më pas të rregullores. Ky është opinionimi që unë po ngrej, për shkak të rëndësisë që ka të themi KED dhe funksionin e tij për rankimin, por mbi të gjitha, për mbarëvajtjen unë mendoj që në grupin e punës të jenë dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese si dhe anëtari i Gjykatës së Lartë. ... Sigurisht nuk do jetë një punë vetëm e grupit, do jetë një punë e administratës së Gjykatës së Lartë, por një opinion e kërkoj nga Gjykata Kushtetuese për shkak edhe të peshës specifike që ka Gjykata Kushtetuese, pra dy anëtarë të japin mendimet ligjore në lidhje me draftet që do përgatiten, por vendimmarrja do jetë e Këshillit ...

Altina Xhoxhaj: Z. kryetar unë me idenë për të qenë anëtare nuk jam dakort. Të hartohet një projekt, një memo nga Gjykata e Lartë dhe pastaj secili prej nesh mund të japë propozimet ose miratimet dhe përfundimisht mund të arrijmë edhe në një produkt ... dhe në mbledhjen tjetër ... jo se unë jam kundër punës në grup bashkë me znj. Tusha si personazhe kryesore, por problemi është që të jemi edhe më transparent dhe të jemi dhe të jetë produkt i të gjithëve. Kaq desha të thoja.

Artan Broci: Mirë nëse ka një mendim tjetër ma thoni se s'ka ndonjë gjë. Pra në qoftë se ka ndonjë opinion që duhet të angazhohen edhe anëtarët e tjerë mirë na bën.

Erinda Ballanca: Pra të jap unë eksperiencën në institucionin tonë se neve kemi bërë një zgjedhje nga këto të juajat. Së pari, janë detyra të reja funksionale që na i ngarkon ligji ... në institucion rast pas rasti. Në institucionin e Avokatit të Popullit është bërë një rregullore për funksionimin e këtyre organeve ... që merren me gjithë procedurën e gjithë kandidatëve që donin të aplikonin. E vërteta është që nuk kemi pasur ndihmë nga institucionet për hartimin e rregulloreve. Përsa i përkiste është një punë rast pas rasti shumë e madhe. Ajo që ne kemi hasur ndihmë rast pas rasti si institucion ka qenë në zgjidhjen e disa problemeve që mund të kemi hasur për të marrë një mendim më të specializuar pranë institucionit të Euraliusit për opinione të ndryshme në lidhje me trajtimin e gjërave që nuk dinim si t'i zgjidhnim për probleme rast pas rasti të trajtimit të kandidatëve, por rregulloret janë bërë nga vetë institucioni, urdhrat janë

nxjerrë nga titullari dhe në cilësi si institucion demokratik dhe ... janë nxjerrë nga titullari për numrin që do përfshiheshin në Komision, do përzgjidhnin kandidatët etj. Pra ka një lloj procedure e cila është bërë nga vetë institucioni dhe për këtë arsye unë mendoj që sekretariati e ka, për sa kohë që ne, të themi Avokati i Popullit ishte sekretariat t'a konsiderojmë i Kuvendit, për listën e emrave që do të shkonin për anëtarët e vetingut, të organeve që do të zgjidheshin në veting. Neve si sekretariat bëmë pikërisht po atë punë për t'a ... gjithë informacionin. Neve si sekretariat po funksionojmë në rastin konkret të themi të një organi për efekt listimi, të bërjes së listës por edhe për efekt të rankimit. Gjykata e Lartë duhet të funksionojë që t'i japi mbështetjen me stafin e tyre dhe prandaj janë sekretariatet me gjithë ... se nuk ka mundësi shteti që tu japi të gjithë këtyre ... që po bën tu japi fonde shtesë për bërjen e këtij procesi dhe prandaj mbyllet rast pas rasti me sekretariatet e Gjykatës së Lartë ose Gjykatës Kushtetuese apo tonën sipas rasteve. Unë mendoj që drafti duhet të, në gjykimin tim, drafti duhet të bëhet shpejt dhe sigurisht mund të çohet edhe për një mendim të një institucioni tjetër për ndonjë koment, por që përse i përket draftit ai duhet të bëhet drejtpërdrejt nga ju, nëpërmjet anëtarëve që janë caktuar nga kryetari i gjykatës.

Ulsi Manja: Atëherë si vepron Komisioni jonë për miratimin e rregulloreve sepse janë disa rregullore që ne miratuar në fazat e konstatimit të ligjeve të reformës në drejtësi. Si projektregullore e miraton stafi i këshilltarëve, por në çdo rast caktohet një relator ose dy nga anëtarët e jurisë. Rregullorja fillon miratohet nga ky lloj komisioni. Kështu që patjetër që relator do të ketë për këtë projektregullore, por hartimin e projektregullores në dinamikë e përgatisin këshilltarët juridikë, jo stafi. Në lidhje me misionin Euralius në përgjithësi ai jep opinionin ligjor për çështje të interpretimit apo zbatimit, në rastin konkret edhe për rregulloren.

Artan Broci: Mirë atëherë. Kush është dakort me propozimin e bërë nga kryetari për caktimin e grupit të punës e përbërë nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese për hartimin e rregullores për t'ia dhënë pastaj anëtarëve të Këshillit për t'a miratuar ?

Rovena Gashi: ... stafi administrativ të jenë ata që do të bëjnë një draftim të rregullores dhe kryetari që jeni juve, kryetari të jetë në cilësinë e urdhëruesit duke qenë që edhe afërsia fizike me këshilltarët e keni ju më komode mënyrën e komunikimit dhe pasi të bëhet një draft tek i cili ne pasi të na niset do kontribuojmë të gjithë me email ... meqë jeni ju në cilësinë e kryetarit në cilësinë e kryetarit të KED dhe e dyta këshilltarët apo stafi administrativ.

Artan Broci: Mirë ka një propozim të ri nga znj. Gashi, ka dhe një propozim nga kryetari i Këshillit. T’i hedhim në votë njëherë propozimin e kryetarit të Këshilli pastaj të znj. Gashi. Kush është dakort për propozimin e parë?

... (flasin njëkohësisht 3 anëtarë pa ndezur mikrofonat)

Artan Broci: ... kryetari i Gjykatës së Lartë, prandaj jua thashë, kryetari i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar një numër të kufizuar nga kërkesat që unë i kam bërë më ka dhënë vetëm një këshilltar ligjor. Kërkesa ime ka qenë një përfaqësues të kabinetit të kryetarit që ka një eksperiencë në hartimin e draftrregullores, megjithatë kryetari i Gjykatës së Lartë me shkresë ka caktuar vetëm një këshilltar ligjor ... por unë propozova që të jetë një grup pune i brendshëm i Këshillit për faktin që duhet një ... për listimin e problematikave që kanë rregulloret ... por në nivelin profesional të japim edhe ne opinionin ligjor që mund të ketë veprimtaria e Këshillit dhe problematikat ... Unë propozova dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, por duke e përfshirë domethënë duke mos e përjashtuar veten si kryetar i KED të jemi në grup pune si më të specializuar ... por drafti pastaj të hartohet prej nesh ... i kalohet pastaj të gjithë anëtarëve të Këshillit pra për tu mos angazhuar i gjithë Këshilli teknikisht në veprimtari. Secili prej nesh do ushtrojë veprimtarinë e tij të përditshme në organet ku është zgjedhur. Në qoftë se informacionin duhet t’jua komunikojmë pra nëpërmjet portaleve të gjithë anëtarëve s’kam asnjë lloj problematike ... sekretaria do jetë e përfshirë, ka marrë adresat tuaja elektronike, e cila vlen më tej në fakt edhe për dërgimin e materialeve të tjera secilit prej jush ... në qoftë se kështu e mendoni ju dakort jam edhe unë s’kam asgjë ... i ftoj më të gjithë anëtarët të përgatisin një opinion ligjor të drafteve nëpërmjet emailit të tyre dhe pastaj të përgatisim relacionin përkatës që do të merret për bazë dhe për hartimin e rregullores së KED. Në qoftë se ka ndonjë çështje që duhet diskutuar, pra si propozim në fund të fundit t’a përgatiti kryetari rregulloren dhe të jetë kryetari relator i rregulloreve, për të kaluar të gjithë materialet te gjithë anëtarët e KED nëpërmjet postës elektronike për të marrë edhe opinionin.

Altina Xhoxhaj: ... të Kushtetutës ku thuhet se Gjykata e Lartë i krijon kushtet e punës për të kryer veprimtarinë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe në nenin 219 që unë jua lexova. Kjo është mënyra më e mirë dhe më transparente për publikun për tu bërë.

Artan Broci: Dakort atëherë siç e lamë, miratohet. Rregullorja do të përgatitet nga këshilltari ligjor, nëpërmjet kryetarit dhe do i përcillet pastaj zyrtarisht me email secilit prej jush.

Enton Dhimitri: Mos duhet paraprakisht të caktojmë se sa rregullore duhet të hartojmë? ... ka një rregullore për pikëzimin dhe ka një rregullore për veprimin administrativ ... kur është miratuar dhe pastaj të jetë tek puna e këshilltarit e miratuar, domethënë të ndajmë në debata që këshilltari administrativ nga tre, katër rregullore sa janë të nevojshme dhe jo vetëm një ose dy. Mos duhet prapë për gjëra që si ka marrë parasysh të hartojmë një rregullore tjetër? Mos duhet t'a bëjmë parimisht këtë? ... Psh. neni 229 pika 2 cakton që KED, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve ... për sa kohë të miratojmë një rregullore ... të paktën dy nga këto rregullore evidencohen.

Artan Broci: Prandaj dhe z. Dhimitri unë ju propozova krijimin e një grupi pune ku përcakton dhe ja propozon Këshillit, i cili sipas ligjit jep opinionin ligjor, pra të ulemi dhe të zbërthejmë një grup pune që të ndajë duhet miratuar kjo rregullore, duhet miratuar kjo rregullore, duhet miratuar kjo rregullore, na detyron ligji dhe kjo nuk mund t'i lihet vetëm një këshilltari ligjor të Gjykatës së Lartë apo një anëtar i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se është në cilësinë e kryetarit prandaj do duhet që të jetë një grup pune. Grupi i punës përgatit edhe raportin për anëtarë dhe thotë të nderuar anëtarë, po them unë opinionin tim, ligji na ngarkon të hartojmë dy rregullore apo tre rregullore dhe e analizon sipas kësaj, sipas kësaj, sipas kësaj dhe po fillojmë punën për funksionimin e kësaj rregulloreje ka këtë draft, e ka këtë draft, e ka këtë draft, siç e parashikon ligji për organet e drejtësisë. Unë prandaj kërkova që të hartohet nga një grup nga Këshilli. Doni që i gjithë Këshilli të përfshihet? Patjetër secili do të përfshihet, veprimtaria e Këshillit është kolegjiale, të gjithë bashkë s'kemi asnjë pengesë ligjore. Secili prej jush në qoftë se do kemi grupin e punës, mendoj që duhet hartuar një rregullore, i cili grup mund të japi mendimin dhe është e zgjidhur, ligji na ngarkon t'a caktojmë vetë rregulloren. Ne kemi për bazë interpretimin e ligjit, por për efekt edhe të ndërtimit të asaj rregulloreje apo numrit të rregulloreve një grup më i vogël i këtij Këshilli për t'a analizuar dhe për të nxjerrë ato që kërkon ligji do i paraqesi një material të gjithë anëtarëve për mbledhjen e ardhshme. Kjo ishte ajo që thamë. Faleminderit. Ka ndonjë pyetje? Pra përfundimisht e diskutojmë, i qëndrojmë propozimit të parë që këshilltari ligjor të jetë caktuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë dhe kryetari i Këshillit të punojë me të apo do doni t'i qëndrojmë grupit të punës, caktimin e një grupi pune që do dali me krijimin e një rregulloreje të re dhe hartimin apo të themi ose asistencën e kryetarit më tej pra për projektin që ne do e diskutojmë pastaj më vonë.

Vitore Tusha: ... unë mendoj kështu se secili prej varianteve të ... por mendoj se puna e këshilltarit është në këtë moment të parë dhe ecet më me shpejtësi të kësaj veprimtarie të organit ... mendoj se jemi në zbatim edhe të formalizmit të kësaj kërkesë ... po patjetër në një moment të parë se më pas në përgatitjet e kësaj veprimtarie ... si përfundim veprimtaria paraprake e përgatitjes së draftit ... do jetë e mundur ...

Artan Broci: Në fakt unë prandaj i jam drejtuar me shkresë i jam drejtuar menjëherë me ardhur në dijëni me shkresën e Kuvendit. Këto janë detyrat që ka kryetari i KED sigurisht në bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës së Lartë në përputhje edhe me Kushtetutën edhe me ligjin. Kryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë shkresën e tij dhe ka caktuar personelin administrativ. Për sa kohë që pavarësisht kërkesës që unë kam bërë për krijimin e një stafi më të gjerë që t'i shërbej Këshillit edhe për shkak të mundësive të pakëta të burimeve njerëzore që ka sot Gjykata e Lartë, patjetër një këshilltar ligjor do ndihmojë Këshillin për rregulloren dhe do relatojë edhe materialet pastaj ... kështu që siç e shihni me mjete të kufizuara jemi.

Vitore Tusha: A mund t'a diskutoni me kryetarin e Gjykatës së Lartë?

Artan Broci: Patjetër që do ja kërkoj por unë jam anëtar i Gjykatës së Lartë dhe e di që Gjykata e Lartë është me numër të kufizuar edhe të anëtarëve por edhe të stafit. Ne pikërisht kemi mbetur nëntë anëtarë që kryejmë detyrën dhe si rrjedhim edhe stafi është i kufizuar. Unë do e diskutoj përsëri me kryetarin e Gjykatës së Lartë ... për funksionin dhe për ngarkesën që ka ky Këshill, por për të qenë sa më transparent me Këshillin ... ka numër të kufizuar për shkak të peshës specifike që ka KED për të renditur. Cilat janë rregulloret që do përgatisim? Prandaj propozova dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, por edhe anëtari i Gjykatës së Lartë, janë më pak të ngarkuar po themi ne, sesa gjyqtarët apo prokurorët që ushtrojnë funksionet e tyre në veprimtarinë e tyre të përditshme dhe përtej detyrës së gjyqtarit, e cila na ngarkohet për shkak të detyrës, por pikërisht për këtë arsye kisha një propozim të tillë dhe jo për arsye për nivel profesional ... por dy gjyqtarët e apelit dhe prokurorët e apelit si dhe gjyqtari i shkallës së parë në veprimtarinë e tyre ... për të cilën na ngarkon Kushtetuta dhe ligji dhe ne midis nesh të gjejmë kush është më pak i angazhuar në detyrat e tij për t'i dhënë një detyrë tjetër që të angazhohet në këto. Ky ishte mendimi që unë kam dhënë. Kjo ishte, ky ka qenë dhe synimi i këtij propozimit tim për dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese duke përfshirë edhe veten sepse jam në funksionin e kryetarit. Mirë nëse s'ka diçka tjetër atëherë kush është me variantin e parë nga Gjykata Kushtetuese apo me variantin e dytë që të angazhohet edhe këshilltari ligjor ?

... (flasim njëkohësisht 2 anëtarë pa ndezur mikrofonat)

Fatos Qato: Unë besoj që kjo është një punë që duhet kryer ... nga ky Këshill. Tashti se e dhatë këtë ide një, dy apo tre, unë do eci sipas atij mendimi që dy mendje është më mirë sesa një, tre mendje është më mirë sesa dy, kështu që s'ka asnjë problem ai propozimi i parë që u bë me tre veta është më i sigurt ... tjetra është një do jetë ... e kemi ne ... ta lemë kështu ... që të shikojmë ...

Artan Broci: Mirë atëherë, kush është dakort me propozimin për krijimin e grupit ... për efekt të procesverbalit znj. Xhoxhaj.

Altina Xhoxhaj: Jo, jam kundër sepse mendoj që organet kolegjiale nuk e kanë këtë pjesë sesi funksionojnë.

Artan Broci: Znj. Gashi.

Rovena Gashi: Unë jam kundër për të ... debatin sepse nuk është në ... debati nëse duhet shtuar stafi administrativ në lidhje me ...

Artan Broci: Z. Qato.

Fatos Qato: Dakort.

Enton Dhimitri: Po, dakort.

Artan Broci: Për efekt të procesverbalit më tepër.

Fatjona Memçaj: Dakort jam.

Gentjan Trenova: Dakort.

Artan Broci: Znj. Tushe.

Vitore Tusha: Pro.

Artan Broci: Z. Jangulli.

Ahmet Jangulli: Pro.

Artan Broci: Mirë në rregull. Kryetari dakort. Miratohet. ... Në lidhje me dy shkresat e ardhura nga Presidenti i Republikës në lidhje me njoftimin për dërgimin e listës për aplikimet për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese ... ardhur në Gjykatën e Lartë më datën 28.02.2018 dhe shkresës të datës 01.03.2018 ardhur në Gjykatën e Lartë po me datën 01.03.2018. Nëpërmjet shkresave kërkohet dorëzimi i dokumentacionit të aplikantëve ... e marrjes së shkresave. Unë mendoj se meqenëse ne kemi konstituuar Këshillin dhe në përputhje me ligjin për të treguar gatishmërinë, sipas ligjit për arkivat nga kryetari i Gjykatës së Lartë është caktuar një punonjëse për protokoll-arkivin e cila do të ... KED në përputhje me parashikimet që parashikon neni 231

për regjistrin zyrtar të KED, unë mendoj se nuk ka ndonjë pengesë në dorë për të marrë në dorëzim ... në rastin e Presidentit ... Kuvendit të Shqipërisë ... kërkesat e aplikantëve dhe sigurisht për të vënë në lëvizje KED. ... Dakort jemi me marrë në dorëzim KED zyrtarisht ... ? Mirë hapim diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës. Znj. Xhoxhaj.

Altina Xhoxhaj: Dakort.

Artan Broci: Faleminderit. Znj. Gashi.

Rovena Gashi: Dakort.

Artan Broci: Z. Qato.

Fatos Qato: Flitet vetëm për administrim me dokumentacion ...

Artan Broci: KED në bazë të ligjit e parashikon.

Fatos Qato: Duhet bërë me procesverbal regjistrimet që u morën kaq.

Enton Dhimitri: Mos jemi para momentit që ndoshta edhe kjo duhet parashikuar në rregullore? Është një kërkesë e ligjit, ndoshta rregullorja i paraprin këtij?

Fatjona Memçaj: Është shumë teknike ... Unë jam dakort.

Enton Dhimitri: Nuk do t'a konsideroja teknike sepse është, e ka ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" si element edhe pjesa e rregullimit të organeve të drejtësisë ka edhe afate të caktuara. Është edhe momenti i diskutimit të afateve. Kështu që pjesa që duhet diskutuar nuk është teknike.

Artan Broci: Unë besoj se tek neni 231 i ligjit, regjistri zyrtar i KED, përcaktohet se kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi sigurohet që Këshilli të ketë në çdo kohë një regjistër zyrtar, në të cilin regjistrohen së paku informacionet e mëposhtme: emrat e kandidatëve dhe institucionet ku ata propozohet të emërohen, institucionet propozuese, dokumentacioni i depozituar prej kandidatëve dhe/ose prej institucioneve propozuese, dokumentacioni i ardhur nga institucionet shtetërore që bëjnë verifikimin e pasurisë dhe të rekordeve penale e disiplinore të kandidatëve, si dhe letërkëmbimi zyrtar mes tyre dhe Këshillit, aktet përfundimtare të Këshillit për verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve, letërkëmbimi zyrtar mes Këshillit dhe Kuvendit ose Presidentit të Republikës. Duke u nisur nga këto kufizime që ka vendosur për regjistrin, por duke ju referuar edhe ligjit për arkivat i kam kërkuar kancelarit të Gjykatës së Lartë të paraqesë në Këshill regjistrin zyrtar. Kancelari i Gjykatës së Lartë ... në bazë të ligjit për arkivat na ka vënë në dispozicion regjistrin zyrtar. Në rradhë të parë ne na kërkohet që të kemi një regjistër zyrtar ku të dokumentohet veprimtaria e tij nëpërmjet institucioneve. Presidenti i

Republikës nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm ka njoftuar, i ka shpallur vakancat, ka administruar dokumentacionin dhe kjo kërkohet të përcillet zyrtarisht. Pastaj veprimtaria e Këshillit dhe renditja apo listimi i kandidatëve lidhen me një fazë tjetër besoj unë të ... miratimit të rregullores sesa veprimit mbi aktet. Aktet nuk mund t'i mbajë Gjykata e Lartë në pikëpamjen time në dorëzim. Unë besoj se duhet t'i marrim ne si KED dhe t'i administrojmë me një procesverbal, thjesht administrimin e këtyre dosjeve që janë në institucionet propozuese. Pastaj hedhja e shortit, veprimtaria e rankimit të tyre, kjo në përputhje me ligjin, i lihet rregullores të verifikohen, të hidhet shorti publik. Do jetë një veprimtari që do jetë po aq transparente si ka parashikuar ligji për organet publike pavarësisht se të dhënat do hidhen në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Por në këtë fazë fakti që Presidenti i Republikës kërkon të dorëzojë dosjet e kandidatëve besoj që nuk ka ndonjë pengesë për të vënë në lëvizje procedurat ne. Procedurat dhe afatet parashikohen nga momenti që ne do i pranojmë.

Enton Dhimitri: Unë kisha diçka të rëndësishme z. kryetar. Po shikoj nenin 235 paragrafi 1 i ligjit dhe konstatoj që veprimi i këtij ligji fillon që nga momenti i dorëzimit të listave, pra nga institucionet e emërtesës ... listat e kandidatëve fillon procesi i verifikimit dhe i kërkohet kandidatëve paraqitja e listës, formularët përkatës të deklaramentit të pasurisë dhe interesave financiare dhe menjëherë jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve ... pastaj janë përfshirë afatet. Gjithë problemi është këtu, në momentin që sot neve do pranojmë, që do pranojmë aplikimet dhe do i kërkojmë institucioneve përkatëse dorëzimin e listave dhe do vi lista nga ana e institucionit, në këtë moment ne nuk kemi përgatitur ende rregullore ... dhe kjo na ve para mospërbushjes së detyrimit ligjor të kërkuar për afatet. Apo jemi në gjendje të arrijmë afatet ? E kemi hartuar rregulloren nga momenti që dorëzohen listat nga kandidatët ? Ndaj kisha bindjen se duhet hartuar rregullorja dhe pastaj të pranojmë listat e kandidatëve.

Artan Broci: A ka ndonjë opinion tjetër ligjor nga anëtarët? Po, z. Jangulli.

Ahmet Jangulli: (Nuk dëgjohet)

Artan Broci: Znj. Tusha.

Vitore Tusha: ... afatet nga momenti ... për rrjedhojë ... organet e drejtësisë ... të ecet paralelisht nga kryetari i cili e ka këtë kompetencë, regjistri është në kompetencë të kryetarit, kryetari bën atë përgatitjen e tij dhe e ka bërë ... t'a shikojmë ndryshe dhe ju jeni në një etapë tjetër ... prandaj paralelisht duhet ... me rregulloren parashikohet puna që Këshilli duhet të kryejë me ...

Gentjan Trenova: ... KED i jep kandidatëve një formular për të plotësuar. Ky formular nuk është hartuar akoma, është pjesë e rregullores ... në një farë mënyre derisa të hartohet formulari.

Artan Broci: Atëherë ligji na referon ne

Gentjan Trenova: Ideja ime është që të pranohen aktet dhe të regjistrohen sipas një numri protokolli, pastaj afati fillon pastaj me regjistrimin e formularit, formularët do hartohen, kjo i përket rregullores së Këshillit.

Artan Broci: Si ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, e njëjta gjë. Këshilli i referon pikërisht dispozitës. Unë besoj se do jetë në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë edhe një rubrikë për KED, është gati, ku do jetë qoftë veprimtaria e organit qoftë formulari sipas ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen apo ndonjë formular tjetër që parashikon ligji, pra secili kandidat nesër do publikohet lista në faqen e KED të hedhura nga ... Kjo lidhet edhe me afatin ligjor në bazë për të aplikuar, për të marrë, për të shkarkuar formularin përkatës dhe për t'i depozituar pranë KED ... por unë nuk besoj se kemi shkuar akoma tek shpallja e listave në faqen e KED-it. Në momentin që ne do të vendosim të shpallen listat në faqen e KED-it unë besoj se do jenë hedhur edhe deklaratat apo detyrimet që parashikon ligji për secilin kandidat që ka aplikuar ... pranë organeve ... që parashikon dhe ligji. Po, përfaqësuesi i apo Avokatja e Popullit, më fal.

Erinda Ballanca: Po atëherë për t'a sqaruar e vërteta është që ky në fakt do të ishte përveç konsultimit ky do të kishte pasur një ... të tipit relacion ... të këshilltarit ligjor eventualisht që është edhe këshilltari juaj në këtë rast, për të parë realisht edhe problematikat në çështjet që do të vijnë për ne si anëtarë në lidhje me publikimin apo me veprime të tjera të cilat neve po efektivisht ... kjo është në fakt një nga detyrat kryesore që kemi marrja e dokumentacionit, përse i përket marrjes së dokumentacionit do të duhet që të nisen procedurat se ka afate të kufizuara të përcaktuara në ligj. Çështja e afateve është një çështje ju vetë e thatë është rasti i parë që po ndodh, ndaj duhet të jemi super korrekt, institucioni që na kërkon llogari për të vetmen arsye që të thotë se ligji për Gjykatën Kushtetuese thotë se procedura duhet të mbarojë brenda 60 ditëve në tërësi nga momenti që janë mbledhur që është shpallur vakanca, nga ana tjetër ligji për funksionim e KED-së përcakton saktësisht disa që duhen përcaktuar rast pas rasti dhe për efekt të kandidaturave disa deklarime që janë të gatshme. Në gjykimin tim kemi të bëjmë në lidhje me pamje të parë kjo do të ishte një gjë që kuptohet një si raportim ndoshta do të ishte, do të ishte më i përshtatshëm, do të kishte qenë më i përshtatshëm është se ... nga ata që janë persona

gjyqtarë pra nëse personat kanë qenë pjesë e deklarimeve janë gjyqtarë apo prokuror kjo është e panevojshme dhe ligji i është referuar rasteve të personave të cilët nuk e kanë bërë ndonjëherë këtë lloj deklarimi. Megjithatë ky konstatim mendoj që duhet të bëhet pjesë e rregullores dhe të thuhet që rast pas rasti rregullorja do të duhet që 1,2,3. Tjetra mund të lindë problemi i formularëve a do të ketë dhe në rastin konkret formularë pjesorë për deklarinin e këtyre personave, në qoftë se e kanë bërë deklarinin sipas ligjit, në rastin konkret po flasim znj. Gashi thotë unë e kam bërë deklarinin tim, a lind detyrimi që kur unë paraqes kërkesë të bëj një deklarin tjetër? Apo mjaftojnë ato deklarime të cilat janë bërë rast pas rasti për efekt të verifikimit për efekt të themi, flasim për rastin e çdo gjyqtari i cili ka aplikuar. Ndërsa ndryshon situata për personat e tjerë të cilët vijnë nga jashtë sistemit. Fakti që neve kemi, të jemi realist kemi afate kohore, duhet vënë në lëvizje dhe duhet të jetë përse i përket në logjikën tonë. Ndoshta do të ishte mirë që ne mendoj unë, a do të ishte më e saktë që ne pavarësisht nuk mund të ndalojmë marrjen e ligjit dhe nuk mund të fshihemi pas tij, në fakt dihet se dokumentat do të merren dhe menjëherë duhet dërguar besoj unë informacioni përse i përket formularit ... të gjithë personat e tjerë dhe të vijojë një rregullore në mënyrë sa më të shpejtë duke pasur një afat 20 ditor, 30 ditor që na le në njëfarë mënyre rreth 20 ditë me ligjin funksional, se ka një kleçkë ligji për Gjykatën Kushtetuese por edhe ligji për organet e drejtësisë ... të mundohemi të ndjekim të paktën afatet më të gjata të ligjit për funksionimin e KED-së duke i konsideruar ato si rregullim specifik në rastin konkret, më vonë të shikojmë se çfarë do të ndodhë me parashikimet e tjera do t'i drejtohen apo nuk do t'i drejtohen ... Afati 60 ditor për hir të së vërtetës ka kaluar gjysma që tani sepse janë shpallur vakancat sepse jemi vërtet në përfundim të, domethënë e kemi kaluar, por bërja e rregulloreve dhe përcaktimi sa më shpejt i detyrave i atyre që janë të mundura për tu bërë profesionalisht tregon vullnetin mendoj unë të institucionit për t'a çuar përpara këtë detyrim që ata kanë marrë.

Artan Broci: Faleminderit. Të marrim opinionin ligjor nga Komisioni i Ligjeve.

Ulsi Manja: Kjo është mbledhja e parë e KED. Nuk ndaj të njëjtin mendim se gjysma e afateve kanë ikur, është tjetër gjë ligji për Gjykatën Kushtetuese është tjetër gjë ligji që rregullon funksionimin e KED-së. Jam shumë dakort që është hapur vendi dhe janë administruar se në fund të fundit lista është bërë publike në faqen e internetit të Presidentit të Republikës, do t'a bëjë së shpejti edhe Kuvendi. Momenti i fillimit të ecjes së afateve është tjetër moment, nga ku do të ecin afatet që përcakton ligji për KED. Unë shoh që në nenin 239 të ligjit pika 2 vërtet ka

një formular për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të integritetit dhe të së shkuarës profesionale e personale të kandidatëve, por do duhet ta miratoni ju me vendim, kështu që jeni ju ata që vendosni. Do përdorni formularët standard që ka ILDKP në rastin konkret për të verifikuar pasurinë apo jo? Në rast se ju vendosni të thoni jo, do jepni disa rubrika, që do i miratojmë, pra ka një moment që ju do duhet t'a miratoni me vendim. Patjetër administrimin e listave po. Menjëherë ... përcakton KED nga cili moment. Kjo është mbledhja e parë, është konstituimi, nuk mund të flitet sot në mbledhje të parë se kanë ikur afatet, ndërkohë që ne sot po diskutojmë jemi në diskutim e sipër të çështjeve të karakterit administrativ të veprimtarisë së këtij Këshilli.

Artan Broci: Po faleminderit, z. Manja. Atëherë përfaqësuesi i Presidentit.

Bledar Dervishaj: Ka diçka përse organet e ... , por jo vetëm midis dy ligjeve të organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e KED si leksion në afate, por edhe në vetë brenda këtij ligji ka afate të ndryshme. Po marrim një rast, ndërkohë që në momentin e shpalljes së vakancës për Presidentin e Republikës nuk është caktuar ndonjë afat ... , për Kuvendin është caktuar deri në ... kështu që na është dashur neve të bëjmë një llogari midis afatit 60 ditor dhe ... që është caktuar 15 ditë ... por 40 ditë për tu rikthyer te dorëzimi ne kemi përcjellë fillimisht listat dhe mendoj që duhet të vazhdoj dokumentacioni, i cili nga ne është inventarizuar në prezencë të subjektit aplikant. Ne do të donim t'a dorëzonim siç është ... , por që ne çdo aplikanti i kemi marrë procesverbal dore ... Kështu që ne dërguam listat dhe mund të them që listën e kemi dorëzuar ... s'funksionon afati pastaj por është një çështje që besoj do rregullohet në rregullore, por ne do dëshironim t'i dorëzonim se po i mbajmë aty në sekretari.

Artan Broci: Po faleminderit. Znj. Gashi.

Rovena Gashi: ... Në lidhje me ... secili nga ne këtu të njëjtën, e njëjta logjikë aplikohet edhe pjesa e formularit që bëjmë ne tani. Duke qenë se unë kam marrë që nga moment i hyrjes në fuqi të ligjit i gjithë sistemi gjyqësor si gjyqtarë dhe prokurorë, ndihmësat ligjor, përse përfshin stafet e prokurorive e kanë kaluar këtë lloj testimi, pra ne vazhdojmë të jemi në detyrë. Fakti që ata gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët kanë pasur probleme, problematikat janë zgjidhur nga institucioni i Presidentit të Republikës në seksionin e dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Ata që kishin gjëra për tu verifikuar ajo domethënë faza e sistemit të drejtësisë është mbyllur të paktën deri tani dhe për t'a ndarë prokurorinë nga gjyqësori, kjo pjesë është e konsumuar pasi Presidenti i Republikës është subjekti i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe jo prokurori domethënë ai ... i cili

kishte iniciativën për të angazhuar strukturën e dekriminalizimit për problematikat që tregonin formularët dhe kjo pjesë për të drejtuar punën kështu që të paktën ne edhe duhet t'a përfshijmë në rregullore dhe ata që vijnë nga gjyqësori, të cilët e kanë plotësuar formularin dhe janë gjetur pa probleme dhe nuk ka nevojë t'a riplotësojnë pasi mund të merret nga institucioni i Presidentit verifikimi që është bërë rast pas rasti.

Fatos Qato: Sot po diskutojmë do t'i marrim apo jo.

... (flasin njëkohësisht disa anëtarë pa ndezur mikrofonat)

Enton Dhimitri: Sot jemi për shpalljen e vakancës nga Presidenti. Atëherë në interpretim të ligjit, neni 235 paragrafi 1, po citoj momentin kohor ku thotë ... fillon detyrimi që ne t'i pajisim kandidatët me formularin përkatës apo kur fillon ky moment. Për mendimin tim afati, ndaj bëra këtë diskutimin e mëparshëm ku thashë që rregullorja duhet t'i paraprijë procesit të regjistrimit jo të regjistrimit, por duhet t'i paraprijë të paktën minimalisht procesit të dërgimit të formularit, po themi dhe regjistrimi tani është ky dhe që nga ky moment të pajisen kandidatët me formularin përkatës. Siç u diskutua më parë, tërë kandidatët që vijnë nga pjesët e gjyqësorit pra ka një kategori që ka sistemi gjyqësor është e qartë që do merren formularët nga Inspektoriati përkatës, por problemi është për kandidatët jogjyqtarë ose joprokurorë çfarë formulari do të plotësojnë dhe ligji ngarkon KED për të miratuar këta formularë.

Artan Broci: Mirë a ka ndonjë tjetër për këtë temë?

Fatjona Memçaj: ... të Presidentit dhe Presidenti kur është shpallur vakanca një ndër dokumentet kanë qenë gjithë formularët dhe besoj se secili nga ato i ka dorëzuar formularët pra janë ... po them t'i bëjmë ndonjë t'i ... I vetmi pastaj që do ketë diskutim do jetë ... por të gjithë formularët e tjerë janë besoj duhet të jenë. Besoj se janë administruar bashkë me dokumentet e tjera, se ligji e sqaron, pra listës i bashkëlidhet formulari ...

Artan Broci: ... përpara KED ne kemi dyfishuar ... në lidhje me ligjin për organizimin e organeve gjyqësore deri tani nuk mund të kthehemi te morali. Pra ideja për t'a mbaruar, përfaqësuesi i Presidentit ka sjellë një shkresë, Presidenti në të drejtën e tij ka shpallur vakancën e parë dhe vakancën e tretë dhe Parlamenti të paktën siç u informuam nga faqja publike në internet ka shpallur vakancën e dytë brenda datës 18 mars për paraqitjen e kandidaturave dhe pastaj ka afatet e veta për ... ne kemi për objekt veprimtarinë e KED-it. Këtu çështja nuk shtrohet nga fillojnë afatet sigurisht ne prandaj në përputhje do hartojmë rregulloren. Me të drejtë z. Manja na solli në vëmendje nenin 229 të ligjit për mënyrën e përcaktimit ndaj vendimmarrjes.

Ndajmë të njëjtin opinion se pas miratimit të rregullore dhe përcaktimit të funksionimit të këtij Këshilli ne na fillojnë afatet, por duhet të miratojmë rregulloren, por nga ana tjetër a mund t'i refuzojë KED organit të Presidentit të Republikës dhe nesër pasnesër të Kuvendit apo të Gjykatës së Lartë të drejtën e tyre për të dorëzuar për ato që janë shpallur? Ne afatet na fillojnë në momentin që ne do miratojmë rregulloren gjykoj unë për funksionimin dhe do të bëhen publike këto rregullore pasi t'i miratojmë dhe do i themi të gjithë kandidatëve nëpërmjet, ne do bëjmë një komunikim individual me kandidatët si dhe komunikim elektronik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, të gjithë kandidatët do kenë akses mund të aksesojnë faqen zyrtare të KED pranë Gjykatës së Lartë dhe do i themi sipas ligjit u miratuan këto rregullore prandaj ... të veprimtarisë së Këshillit. Do bëjnë ankim? Rregullorja ka miratuar atë që parashikon ligji, këtë jo dhe mund t'a shkarkojë në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë dhe formularët zyrtarë. Pra këtë veprimtari do t'a miratojë Këshilli dhe ne sigurisht nga ky moment që miratohen rreguloret dhe kriteret do i përcaktojë ligji nga ky moment na fillon edhe afati pastaj ligjor për t'i ... ato, por ... Akti që ato dorëzojnë aplikimet e tyre ne nuk na kushtëzon me afate se ne mbledhja e parë jemi, ne sigurisht do t'a fillojmë nga momenti që kemi miratuar rregulloren do të bëjmë veprimtarinë e rregullore do bëjmë publike edhe listat ... Ky është opinionimi im për KED. Faleminderit. Ka diçka tjetër? Dakort atëherë që të marrim në administrim dosjet në regjistrin zyrtar të KED dhe veprimtaria e afateve të fillojë në momentin që ne miratojmë rreguloret? Dakort jeni?

Rovena Gashi: Atëherë z. kryetar kam vendosur të abstenoj lidhur me pikën e rendit për marrjen në dorëzim të kandidaturave.

Anëtarët e tjerë u shprehën dakort.

... (flasim disa anëtarë njëkohësisht pa ndezur mikrofonat)

Artan Broci: Sepse ligji na ngarkon të hartojmë disa rregullore t'i miratojmë të përcaktojmë kriteret. Ne nuk do të shprehemi për afatet, të paktën të kemi diçka. Veçanërisht në mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë të vendimmarrjes kërkohet që miratimin e rregullave të caktuara në legjislacion nëpërmjet rregullore dhe prandaj them ne kur jemi ... rastet sigurisht anëtarët nëpërmjet ... të përgatisim një material si relacion, marrim edhe opinionet ligjore dhe në momentin që ne vendosim për t'a miratuar atë rregullore pastaj i bëjmë publike, transparente në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë ... në pikëpamjen time. Në qoftë se ka diçka tjetër. Mirë atëherë e njëjta situatë është edhe me materialet të cilat janë depozituar pranë Gjykatës së Lartë

në adresë të KED përpara se të mblidhej ky Këshill. Unë e kam te pikat e tjera dhe për shkak, të paktën në opinionin tim, siç po veprohet edhe me materialet që do dorëzojë Presidenti i Republikës dhe nesër edhe Kuvendi i Shqipërisë edhe në Gjykatën e Lartë ka materiale të cilat janë depozituar për efekt të KED të mëparshëm, i cili nuk ka funksionuar dhe unë gjykoj që nuk ka ndonjë pengesë që të administrohen nga ky Këshill ato dokumentacione që janë depozituar pranë Gjykatës së Lartë për KED e mëparshëm. Kështu që në bazë të aplikimeve që ka pasur Gjykata e Lartë për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe materiale të tjera të cilat mund të jenë, nuk e di se çfarë janë por që i janë drejtuar KED-së ndoshta edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë kandidaturat dhe të regjistrohen në regjistrin e KED. Se janë gjëra që i janë dorëzuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë, pavarësisht se KED ... mendoj se duhet të administrohen nga ky Këshill gjithë materialet pranë Gjykatës së Lartë. Në qoftë se ka diçka tjetër? A ka ndonjë tjetër opinion ligjor? Dakort jeni t'i administrojmë dokumentet? Për regjistrimin, pra të regjistrohen te regjistri i Këshillit. Kjo është ideja

Ulsi Manja: A mund të bëj një pyetje?

Artan Broci: Po.

Ulsi Manja: Lidhur me materialet që janë depozituar në Gjykatë të Lartë unë e shoh më ngushtë. Çfarë do administrohet? Ne jemi në një procedurë të administrimit të kandidaturave për Gjykatë Kushtetuese që vijnë nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë. Janë këto institucionet që miraton ligji të depozitojnë kandidaturat pranë KED. Pyetja ime është lidhur me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kush e ka bërë shpalljen për kandidaturat e gjyqtarit ose jomagjistratit që do duhet të administrohen? Është tjetër shpallja e KED, kjo shpallje nuk është bërë kurrë nga Këshilli, sepse nuk është konstituuar asnjëherë. Ndoshta për ... janë kandidaturat që vijnë për Gjykatë Kushtetuese është e përcaktuar Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë në këtë kuptim ... institucionet në respekt të ligjit ato shpallin kandidatura, kanë administruar dokumentacionet dhe do t'a sjellin pranë KED-së ... jemi dakort. Por për një institucion tjetër siç është ILD për të cilën nga KED-ja nuk ka pasur një procedurë shpalljeje publike siç e përcakton ligji, ne nuk jemi dakort të administrojmë kandidatura. Mund të nisë me shpallje të re, mund të administrohen kandidaturat nga e para, për këtë jemi dakort.

Artan Broci: Pra nga administrata e Gjykatës së Lartë është ngritur si shqetësim se si do të veprohet me aplikimet ekzistuese dhe dokumentacionin ekzistues të dorëzuar në Gjykatën e Lartë në adresë të KED-së. Pra që ka pasur përpara. Do t'i verifikojmë. A do i mbajë KED këto,

këto janë bërë më përpara, a do i shohim se çfarë ka përpara se të bëjmë një lloj regjistrimi, të verifikojmë. Mund të ketë edhe nga këto që kanë ardhur kërkesë direkte për inspektor që me aplikimin e parë pavarësisht se pra, tërë ideja të verifikojmë çfarë kanë depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Lartë për efekt të KED-së sepse edhe vetë Gjykata e Lartë ka bërë publike kandidaturat e veta për dhe ka listuar për vakancat tek Gjykata Kushtetuese dhe sigurisht ajo kërkon t'ia japi KED. KED-ja s'ka ekzistuar.

Erinda Ballanca: Do të konsiderohen aplikime për vendet vakante, çfarë do konsiderohen?

Artan Broci: Për vakancat po flasim ne.

Erinda Ballanca: Në mendimin tim, kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili administron atë që po kërkon deri më tash nuk ka pasur deri tani një organ tjetër ku do shkonin këto dokumenta. Në parimin e të drejtës administrative edhe kur vjen një kërkesë apo ankesë dhe i drejtohet një organi, le të jetë organi i gabuar, në rastin konkret ka qenë Gjykata e Lartë organi i gabuar, pra ajo ka qenë sekretariati, në gjykimin tim kryetari i Gjykatës së Lartë në momentin që u konstitua si organ me një shkresë përcjellëse ja dërgon KED-së në lidhje me një datë të cilën i dërgohet. Se çfarë do ndodhi pataj rast pas rasti me çdo shkresë tjetër mund të jetë subjekt ose objekt në diskutim të këtij Këshilli, prandaj thashë që fjala administrim është si fjalë e madhe, por që përcjellja nga ana e kryetarit të Gjykatës së Lartë në gjykimin tim të dokumentacionit të mbetur në këtë institucion para konstituimit do të bëhet me një akt formal prej tyre. Ne nuk mund të mos e, ne si organ nuk mund të mos ja pranoni marrjen e këtij dokumentacioni. Pastaj çdo ndodhi rast pas rasti është gjë tjetër. Ndërkohë ai ka për të na dhënë sqarime.

Artan Broci: Po, z. Gjonçaj.

Genci Gjonçaj: Unë mendoj që aplikimi apo materializimi është rrjedhojë e një procesi ligjor. Pra nëse ka pasur një shpallje apo procedurë apo detyrim ligjor të parashikuar në legjislacion nuk jemi para një rasti të tillë. Kryetari i Gjykatës së Lartë pavarësisht se ... regjistron ato që vijnë si rezultat i një procesi të pastër ligjor dhe jo të një interesi të caktuar dhe me iniciativë të kandidatëve. Ka shumë njerëz që mund të jenë regjistruar për zgjedhje në institucionet e drejtësisë, është në të drejtën e tyre por ... që të aplikojnë. Por kjo nuk jemi para tyre, duhet që institucioni më së pari të krijojë dhe të lançojë interesin që ka për një vend apo për një tjetër. Siç është rasti i Presidentit kur hedh konstatimin e vakancës, Presidenti bëri shpalljen për dy anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ... çfarë del nëse jemi para këtij rasti jemi dakort që të administrohen nëse jemi para rasteve të tjera atëherë ... që të kuptojmë kush do jetë

dokumentacioni, por qëndrimi im unë besoj që qëndrimi që duhet të ketë KED ... në këtë rast do të jetë në përputhje me interesin e institucionit në ngarkim. Nëse nuk kemi një interes ligjor nga subjekti në këtë rast ...

Erinda Ballanca: Po për dokumentat që janë sjellë si t'ia bëjmë janë mbajtur kot?

Genci Gjonçaj: Po, pra në qoftë se ai ka sjellë kandidim për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë kush ja ka kërkuar

Erinda Ballanca: Atëherë t'a shpjegoj unë. Këtë gjë nuk e vendos. Më fal një sekondë ka ardhur një shkresë në këtë institucion kur s'ka të drejtë t'a mbajë çfarë do ndodhë

Genci Gjonçaj: Do i them drejtoju, drejtoju

Erinda Ballanca: Më fal t'a mbaroj dhe rasti konkret, po mirë pra, se parimi është e kundërta, personi mund t'i drejtohet dhe organit të gabuar dhe organi ia çon atij organi që ka të drejtë që në momentin.

Genci Gjonçaj: Kur ka një interes të organit, kur s'ka interes çfarë

Erinda Ballanca: Po prit pra. Në rastin konkret ajo që unë po diskutoj në gjykimin tim ishte ndoshta fjala administrim ishte fjala që duhej, por që duhet përcjellë diku informacioni, pastaj rast pas rasti do vendosim, merret një vendim rast pas rasti për çdo shkresë se ne nuk e dimë realisht cila është brendia e shkresës që do të vijë, por ama për sa kohë që u krijua sot organi, paska pasur për shkak të ligjit depozitime në këtë institucion, për arsye nga më të ndryshmet, të cilat neve sot nuk i dimë do verifikohet, por duhet të përcillet njëherë materiali me informacion dhe do verifikohet rast pas rasti dhe do vendoset. Se do jetë ky organi që ka për t'ja kthyer pa veprime po them unë x apo y kërkesë apo shprehje interesi duke dhënë edhe arsyetimin përkatës sepse ne çdo dokument ne do duhet të japim edhe arsyetimin për çdo akt që organi merr. Nuk mund t'a lesh në heshtje se është i kundërt parimi që kur e lëmë në heshtje ato janë pranuar. Ato janë lënë në heshtje për një kohë të gjatë prandaj në gjykimin tim do të ishte më e drejtë që nëse do dërgoheshin me shkresë përcjellëse këto materiale të vlerësohen rast pas rasti nga ana e KED se çfarë do bënte rast pas rasti. Faleminderit.

Ulsi Manja: Shpreh qëndrimin zyrtar të Komisionit ... Nuk mendoj që KED-i të administrojë një shprehje interesi që nuk e ka kërkuar askush. Sigurisht që ju sot mund të paraqisni një shprehje interesi, le të themi për të shkuar Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara kur s'ka shpallje. Kandidatët që kanë paraqitur shprehje interesi pa e kërkuar asnjëri nga organet publike janë të lirë të riaplikojnë në momentin që organi kompetent ligjor, siç është

KED-i në rastin konkret, të bëjë njoftimin dhe shpalljen publike për ato vende, flas për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, siç është rasti i tre institucioneve dhe për inspektor, siç do të jetë shpallja që do të vendosim në mbledhjet e ardhshme. Pra jam me këtë, varet nga tipologjia e kërkesës. Në rast se kanë qenë kërkesa për në Gjykatë Kushtetuese ne sot kemi tre organe që kanë paraqitur listën e kandidatëve ... ligji një procedurë të caktuar kushtetuese dhe ligjore dhe jo mbetjet mbi tavolinën tuaj si KED, por në rast se bëhet fjalë për kërkesa të tipologjisë që kanë lidhje me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë nuk mund KED-i të administrojë shprehje interesi nga kandidatë jomagjistrat, kur nuk ka pasur një shpallje publike nga KED, i cili për hir të së vërtetës, sot ka mbledhjen e parë konstituive, sipas Kushtetutës dhe ligjit. Në momentin që do ketë një shpallje publike nga ana juaj, jo një, por janë të lirë çdokush që plotëson kushtet dhe kriteret e vendosura në Kushtetutë dhe ligj të aplikojë për këtë vend.

Genci Gjonçaj: Do ishte e padrejtë kryetar nëse do administroheshin ...

Artan Broci: Me të drejtë e konsideroi edhe Avokatja e Popullit, pra nuk bëhet fjalë për administrim, por për inventarizim të atyre akteve të cilat janë depozituar në Gjykatën e Lartë për ish KED. Atëherë Gjykata e Lartë ka shpallur vakancën për një nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese ... Mund të ketë edhe akte të tjera, të cilat unë nuk e di se çfarë janë, që janë marrë në administrim, janë marrë në dorëzim nga protokollin e Gjykatës së Lartë. Thjesht për t'i inventarizuar pastaj ne e shohim kanë lidhje me funksionin e KED-it apo s'kanë lidhje, por për t'i marrë në dorëzim, për t'i inventarizuar për regjistrin e KED-it, akte të cilat janë depozituar pranë Gjykatës së Lartë, unë mendoj se nuk ka ndonjë pengesë. Pastaj ne e vlerësojmë kanë lidhje me veprimtarinë tonë apo s'kanë lidhje dhe i kthehet përgjigje qoftë funksionarit apo individit që e ka sjellë apo organi që e ka depozituar për ... Apo mendoni se duke filluar nga sot duhet t'i bëjmë thirrje publike organeve kushtetuese qoftë edhe Gjykatës së Lartë të depozitojë në qoftë se ka vakancë të shprehur për të dhe pastaj pas miratimit të rregullores të bëjmë shpallje publike edhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Unë mendoj që inventarizimi dhe informimi i KED me përmbajtjen e këtyre akteve dhe pastaj vendimmarrja dhe kthimi i përgjigjes të secilit individ apo të secilit institucion në përputhje me ligjin nuk na pengon ne në ushtrimin e veprimtarisë sonë. Nuk besoj se ka ndonjë pengesë. Mirë t'i kërkojmë atëherë zyrtarisht Gjykatës së Lartë inventarizimin e akteve që ka? Mirë, në qoftë se nuk ka diçka tjetër për të shtuar atëherë deklarohet e mbyllur mbledhja për seancën e sotme. Mbledhja e ardhshme do njoftohet nga sekretariati. Faleminderit të gjithëve për kontributin dhe pjesëmarrjen.

Mbajti Procesverbalin

Redjona Myrtja

Anëtarët e KED-së

Artan Broci

Altina Xhoxhaj

Rovena Gashi

Gentjan Trenova

Fatjona Memçaj

Enton Dhimitri

Fatos Qato

Ahmet Jangulli

Vitore Tusha

Shkëlzen Selimi

Sotiraq Lubonja